



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 127

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZBATIMIN E LEHTËSIRAVE
DOGANORE DHE/OSE KONTROLLIT TË HYRJES/DALJES SË
MALLRAVE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZBATIMIN E LEHTËSIRAVE
DOGANORE DHE/OSE KONTROLLIT TË HYRJES/DALJES SË
MALLRAVE**

Neni 1
Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e lehtësirave doganore dhe/ose të kontrollit të hyrjes/daljes së mallrave.

Neni 2
Dokumentet e bashkëngjitura

Në shtojcën e këtij Ligji është i bashkëngjitur teksti i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e lehtësirave doganore dhe/ose të kontrollit të hyrjes/daljes së mallrave

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-127
24 shkurt 2022

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës